



Alberta Breshej  
[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 1833 / Prot. 13

Vlorë më, 21 . 11 . 2022

VENDIM

Nr. 37, datë 21.11.2022

F. Zekaj  
[Signature]

PËR

**HAPJEN DHE MIRATIMIN E TARIFËS SË SHKOLLIMIT PËR PROGRAMIN E  
CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE MASTER PROFESIONAL NË MËSUESI PËR  
ARSIMIN FILLOR KL. I-V**

Në mbështetje të nenit 3, pika 3, gërma ç, nenit 49, të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 25, pika 1, gërma i, Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë Udhëzimit nr.1, datë 14.04.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar, Vendimit nr.48, datë 14.11.2022 të Senatit Akademik si dhe referuar propozimit të Administratorit ardhur me shkresën nr.1728 prot, datë 11.11.2022, Bordi Administrimit në mbledhjen e datës 21.11.2022,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Edukimit për hapjen e programit të ciklit të dytë të studimeve Master Profesional në Mësuesi për Arsimin fillor Kl. I-V.
2. Të miratojë tarifën për programin e ciklit të dytë të studimeve Master Profesional në Mësuesi për Arsimin fillor Kl. I-V si më poshtë:

| Emërtimi I programit   | Kreditet e programeve te ciklit te dytë te studimeve | Tarifa per kredite ne nje program te pare ciklit te dytë te studimeve | Tarifa e shkollimit per nje program te pare te ciklit te dytë te studimeve | Tarifa per kredite ne nje program te dyte te ciklit te dyte te studimeve | Tarifa e shkollimit per nje program te dytë te ciklit te dytë te studimeve |
|--|--|---|--|--|--|
| Program master Profesional "Master profesional në mësuesi për arsimin fillor kl. I-V " | 120  | 1000  | 120,000  | 1200   | 144,000  |

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR  
Sotir NIKOLLA



[Signature]